REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE PROKURIMEVE DHE ZBATIMIT TË KONTRATAVE
SEKTORI JURIDIK DHE PROKURIMEVE

Nr. 3064 Prot.

Datë 23/09/2025

RELACION

PËR PROJEKT-VENDIMIN

"PËR NJË NDRYSHIM TË VKB NR. 65 DATË 23.07.2021 " PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PRONARËVE PASURITË E PALUAJTSHME TË TË CILËVE DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI I RRUGËVE VENDORE LAGJIA NR 2 DHE 3 DHE ZGJERIMI I RRUGEVE VENDORE AKS SUPERSTRADA E DEVOLLIT, ISMAIL QEMALI, DEMIR PROGRI; AKS RRUGA ETEM OSMAN XHACI" DHE PROJEKTIT "REHABILITIMI I RRUGËVE TË QYTETIT 2" SI DHE VLERËN FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT"

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Bashkisë Devoll!

Në mbështetje të neneve 9 pika 1.2 gërma b) dhe 54 të ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar , në bazë të pikës 1 të nenit 5 dhe të pikës ç të nenit 8 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik'' i përditësuar , bazuar në VKM nr.89 datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në RSH"po ju paraqesim relacionin mbi projekt-vendimin si më poshtë:

Bashkia Devoll është duke zhvilluar procesin e shpronësimit për pronarëve pasuritë e paluajtshme të të cilëve do të shpronësohen për realizimi i projektit "Rehabilitimi i rrugëve vendore lagjia nr 2 dhe 3 dhe zgjerimi i rrugeve vendore aks superstrada e Devollit, Ismail Qemali, Demir Progri; aks Rruga Etem Osman Xhaci" dhe projektit "Rehabilitimi i rrugëve të qytetit 2" si dhe vlerën financiare të shpronësimit.

Gjatë verifikimit të dokumentacionit u konstatua se janë bashkuar të dy projektet "Rehabilitimi i rrugëve vendore lagjia nr 2 dhe 3 dhe zgjerimi i rrugeve vendore aks superstrada e Devollit, Ismail Qemali, Demir Progri; aks Rruga Etem Osman Xhaci" dhe projekti "Rehabilitimi I rrugëve të qytetit 2" si dhe vlerën financiare të shpronësimit" në një **Vendim** konkretisht **Vendimi I Këshillit Bashkiak nr. 65** datë **23.07.2021 "Për miratimin e listës së pronarëve pasuritë e paluajtshme të të cilëve do të shpronësohen për realizimi i projektit "Rehabilitimi i rrugëve vendore lagjia nr 2 dhe 3 dhe zgjerimi i rrugeve vendore aks superstrada e Devollit, Ismail Qemali, Demir Progri; aks rruga Etem Osman Xhaci" dhe projektit "Rehabilitimi i rrugëve të qytetit 2" si dhe vlerën financiare të shpronësimit".**

Për këtë arsye për të vazhduar me tej me procedurat e shpronësimit për pronarët dhe pasuritë e paluajtshme të të cilëve do të shpronësohen kërkojmë **ndarjen e projekteve nga njëri tjetri** sepse lista e pronarëve pasuritë e paluajtshme të të cilëve do të shpronësohen janë të ndryshme

Konceptoi :Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve

Eriksela Avdo

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE PROKURIMEVE DHE ZBATIMIT TË KONTRATAVE
SEKTORI JURIDIK DHE PROKURIMEVE

PROJEKT-VENDIM

NR 58 DATË 23/9 /2025

"PËR NJË NDRYSHIM TË VKB NR. 65 DATË 23.07.2021 " PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PRONARËVE PASURITË E PALUAJTSHME TË TË CILËVE DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI I RRUGËVE VENDORE LAGJIA NR 2 DHE 3 DHE ZGJERIMI I RRUGEVE VENDORE AKS SUPERSTRADA E DEVOLLIT, ISMAIL QEMALI, DEMIR PROGRI; AKS RRUGA ETEM OSMAN XHACI" DHE PROJEKTIT "REHABILITIMI I RRUGËVE TË QYTETIT 2" SI DHE VLERËN FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT"

Bazuar në nenet 9 pika 1.2 gërma b) dhe 54 të ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar , në bazë të pikës 1 të nenit 5 dhe të pikës ç të nenit 8 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik'' i përditësuar , bazuar në VKM nr.89 datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në RSH"

PROPOZOJ:

1. Ndarjen e projekteve "Rehabilitimi i rrugëve vendore lagjia nr. 2 dhe 3 dhe zgjerimi i rrugëve vendore aks superstrada e Devollit , Ismail Qemali,Demir Progri; aks rruga Etem Osman Xhaci" nga projekti "Rehabilitimi I rrugëve të qytetit 2" si dhe vlerën financiare të shpronësimit.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Juridike, Prokurimeve dhe Zbatimit të Kontratave,Drejtoria e Urbanistikës dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit.

3. Ky vendim do të hyjë në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të ligjit nr.139/2015 data 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar

Konceptoi dhe konfirmoi bazën ligjore: Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve
Eriksela Avdo

Miratoi:Sekretari i Përgjithshëm
Adriana Rushita

KRYETARI I BASHKISE
EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +355811123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com